



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1401/1 Prot.

Elbasan, më 07.02.2023

VENDIM

Nr 7 Datë 31/01 /2023

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 31/01 /2023, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, mbi përcaktimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a. si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për tatimpaguesit familjarë, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8, 9, 54 të tij, ligjin 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", ligjin 9632 datë 30.10.2016 "Për systemin e taksave vendore", i ndryshuar,

Vendosi:

- 1- Të miratojë Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për tatimpaguesit familjarë.
- 2- Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh.a. do të përfitojë 5% të vlerës së taksave dhe tarifave të arkëtuara për këtë shërbim.
- 3- Të miratojë draftë marrëveshjen me shoqërinë UKE sh.a. sipas draftit bashkangjitur dhe autorizon Kryetarin e Bashkisë për nënshkrimin e saj.
- 4- Ngarkohet Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore me zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes.

Konceptoi:

Juriste :

D.T.T.M.A:

D.P.A.T.T.B.F:

Drejt. Juridike:

Ester Ruci

K. Çullhaj

Q. Tusha

A. Hoxha

SEKRETARI

Elvi Çuni

KRYETARI

Hektor Çiftja



161
31.1.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 617/11 Prot.

Elbasan, më 31.01. 2023

Vendim

Nr. 6 Datë 31/01 /2023

Për miratimin e rinovimit të kontratës së ***“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Elbasan”*** në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a. midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 31.01.2023, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore e Bashkisë Elbasan”, bazuar në:

Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” nenet 8, 9, 54 të tij;

Ligjin Nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;

Ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenet 9 e 11;

Vendosi

1. Të miratojë rinovimin e kontratës së ***“Shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të bashkisë Elbasan”***, në “Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit midis Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., sipas draftit bashkangjitur, për vitin 2023.
2. Ngarkohen Kryetari dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi:

Dr.DPSHU	T. Sinanaj
Dr. PSHI	S. Mehmet
Dr. Finac/Buxhet	A. Merkja
Dr.Juridike:	A. Hoxha
Dr.Pro. Publik:	O. Kokunja

SEKRETARI

Elvi Çuni

KRYETARI

Hektor Çiftja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "ECO-ELB" SHA

Nr. ____ Prot.

Datë ____ . ____ . 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. ____ Prot.

Datë ____ . ____ . 2023

KONTRATË SHËRBIMI PUBLIK

PËR

PRANIMIN, DEPOZITIMIN DHE TRAJTIMIN E MBETJEVE

TË BASHKISË ELBASAN në Impjantin e trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit

Lidhur sot më datë ____ / ____ / 2023, midis palëve:

-**Bashkia ELBASAN**, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, që funksion sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Elbasan, me adresë: *Lagjja "11 Nëntori", rruga "Qemal Stafa"*, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, **z. Gledian Llatja**, referuar për efekt të kësaj kontrate si "**Autoriteti Kontraktor**",

dhe

-Shoqëria "ECO-ELB" sh.a., e regjistruar në QKB në datë 6.12.2021, me numër identifikimi NUIS M13606204T, me seli në Elbasan, përfaqësuar nga administratorj **Z. Leli Kaja**, I datëlindjes 15.04.1976, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan me shtetësi *Shqiptare*, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokument identifikimi, letërnjoftimi nr. H60415101W, referuar në këtë kontratë si "**Shoqëria Kontraktuese**".

Neni 1

Baza ligjore

Kjo kontratë referohet dhe lidhet bazuar në:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Ligji Nr.160/2020 "Për prokurimin publik" (neni 11, pika 1);
- Ligji Nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligji Nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;
- Plan i Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve 2010-2025 dhe Shtojcat për zbatimin e tij;
- VKM Nr.99, datë 18.02.2005 "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve";
- VKM Nr.452, datë 11.07.2012 "Për lëndfillet e mbetjeve";
- Vendimi i Asamblesë/Këshillit Mbikqyrës së "ECO-ELB" sh.a. Nr.3, datë 02.03.2022 "Për miratimin e Planit Ekonomik për vitin 2022 dhe tarifave për trajtimin e mbetjeve pranë Shoqërisë "ECO-ELB" sh.a.



- Kontrata e qirasë Nr.548, datë 21.02.2022 midis Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe “ECO-ELB” sh.a.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. datë

Neni 2

Qëllimi i kontratës

Kjo kontratë ka si qëllim rregullimin e marrdhënieve midis palëve, në procesin e pranimi të depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Elbasan, në impijantin e përpunimit me djegie të mbetjeve (inceneratorin e Elbasanit) në administrim të shoqërisë “ECO-ELB” sh.a..

Neni 3

Përkufizime

3.1. “Mbetje urbane”, në kuptim të kësaj kontrate përfshihen të gjitha mbetjet (sipas përkufizimit që bën Ligji nr.10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar) që grumbullohen dhe vijnë nga Bashkia ose nga operatori ekonomik (ose bashkimi i operatorëve) i përzgjedhur dhe i kontraktuar nga Bashkia, për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Elbasan.

3.2. “Menaxhim i integruar i mbetjeve” është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve.

3.3. “Impiant incinerimi” është impianti i administruar nga Shoqëria kontraktuese, sipas marrëveshjes së lidhur midis kësaj të fundit dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Impianti i incinerimit është ndërtuar nga shoqëria “ALBTEK ENERGY” sh.p.k., sipas Kontratës së Koncesionit të formës “BOT”, me Nr.11026/7, datë 16.12.2014, të lidhur midis Ministrisë së Mjedisit, dhe shoqërisë “ALBTEK ENERGY” sh.p.k. dhe që përdoret për trajtimin termik të mbetjeve. Ky përkufizim mbulon vendndodhjen dhe të gjithë impiantin e incinerimit, përfshirë të gjitha linjat e incinerimit, vendin e pranimi të mbetjeve, të magazinimit, impiantet e paratrajtimit në vend, sistemet e furnizimit me mbetje, lëndë djegëse dhe ajër, bojlerët, impiantet për trajtimin e gazrave të shkarkimit, impiantet për trajtimin ose magazinimin në vend të tepricave të mbetjeve dhe ujërave të përdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit të operacioneve të incinerimit, të regjistrimit dhe të monitorimit të kushteve të incinerimit.

3.4. Përkufizimi i termave të tjerë të kësaj kontrate do të bëhet sipas përkufizimeve që bëhet në kuadrin ligjor dhe nënligjor aktual në fuqi.

Neni 4

Objekti i kontratës

4.1. Objekt i kontratës është pranimi, depozitimi (grumbullimi) dhe trajtimi i mbetjeve urbane të Autoritetit Kontraktor në impiantin e incinerimit të mbetjeve, i ndërtuar dhe i licencuar për këtë qëllim, në administrim të shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., kundrejt pagimit të çmimit të kontratës.

4.2. Shoqëria Kontraktuese do të ofrojë shërbimin për pranimin, grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan, ku do të përfshihen shërbimet si më poshtë;



- i. **Pranimi** i mbetjeve që do të depozitohen nga vetë Bashkia apo nga operatori ekonomik, i cili është kontraktuar nga Bashkia për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë Elbasan, i përbërë nga territori administrativ i Bashkisë (qytetit) Elbasan, si dhe pranimi i mbetjeve të njësive administrative (rajonet) e bashkisë Elbasan: Bradashesh, Papër, Funar, Gracen, Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Shirgjan, Shushicë, Gjinar, Zavalinë, Tregan, Gjergjan.
- ii. **Grumbullimi** (depozitimi) i mbetjeve sipas pikës (i) në vend depozitimit të mbetjeve të “Impiantit të incinerimit”.
- iii. **Trajtimi** që përfshin përpunimin (seleksionimin) e mbetjeve që do të depozitohen sipas pikave të mësipërme.
- iv. **Incenerimi** (djegia) nëpërmjet “Impiantit të incinerimit” të mbetjeve që do të depozitohen dhe përpunohen sipas pikave të mësipërme.

4.3. Shoqëria Kontraktuese do të ofrojë shërbime rajonale të menaxhimit të mbetjeve, si më sipër, në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe Lejen Mjedisore.

4.4. Për shërbimet e kryera, Shoqëria Kontraktuese do të përfitojë pagesën sipas përcaktimeve në këtë kontratë.

Neni 5

Afati i Kontratës

5.1. Afati i kësaj kontrate fillon me lidhjen e saj dhe përfundon në datë 31/12/2023.

5.2. Pavarësisht afatit të parashikuar në pikën (1), efektet e kësaj kontrate do të ndërpriten para afatit të mësipërm, në momentin që do të kete ndryshime në statusin apo në raportet që shoqëria “ALBTEK ENERGY” sh.p.k. ka me institucionet e shtetit Shqiptar, ndryshime këto që sjellin efekt në administrimin e Impiantit të Incenerimit dhe në zbatimin e kësaj kontrate.

5.3. Efektet e kësaj kontrate nuk do të ndërpriten para afatit të mësipërm, nëse gjatë kësaj periudhe (deri më 31.12.2023) “Impianti i incinerimit” i transferohet në pronësi shoqërisë Shoqërisë “ECO-ELB” sh.a, në zbatim të Kontratës Koncesionare të formës “BOT”, me Nr.11026/7, datë 16.12.2014, e lidhur midis Ministrisë së Mjedisit, dhe shoqërisë “ALBTEK ENERGY” shpk, me objekt “Ndërtimin, Operimin (administrimin) dhe Transferimin e Impiantit të Përpunimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Elbasan”.

5.4. Pavarësisht parashikimit të dispozitave të mësipërm, kjo kontratë do të shtrijë efektet edhe për ngarkesat e mbetjeve, të depozituara në incenerator nga Bashkia Elbasan, prej datës 1 Janar 2023 deri në datën e lidhjes së kësaj kontrate. Edhe për këto ngarkesa mbetjesh, shoqëria “ECO – ELB” sh.a. do të lëshojë faturë tatimore, duke respektuar parashikimet e kësaj kontrate.

Transporti i mbetjeve dhe metodologjia e shërbimit

6.1. Transportimi i mbetjeve për në vendgrumbullimin e shoqërisë kontraktuese do të bëhet nga Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet operatorit ekonomik, i cili është kontraktuar nga Bashkia për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë, si dhe nëpërmjet transportuesve të tjerë të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor (psh. për njësitë administrative rurale). Shoqëria kontraktuese i merr në dorëzim ngarkesat e mbetjeve tek hyrja e vendgrumbullimit të Impiantit të incinerimit.

6.2. Shoqëria kontraktuese nuk do të pranojë mbetje të cilat ndalohen nga leja mjedisore dhe

mbetje të tjera të klasifikuara si të rrezikshme sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve (si psh. mbetjet spitalore, bateritë e vjetra dhe akumulatorët, pajisjet elektrike dhe elektronike, vajrat e përdorur, etj.).

6.3. Dërgesat e mbetjeve do të kontrollohen, do të peshohen dhe do të regjistrohen në vend-depozitim menjëherë. Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet operatorit ekonomik, i cili është kontraktuar nga Bashkia për pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve të Bashkisë, si dhe transportuesit e tjerë të autorizuar nga Autoriteti Kontraktor, pajisen me fletë-peshimin e gjeneruar nga peshorja për çdo sasi të depozituar.

6.4. Vend depozitimi do të jetë i hapur gjatë gjithë ditëve të javës, për 24 orë pa ndërprerje, për të pritur mbetjet.

Neni 7

Çmimi i Kontratës

7.1. Pagesa e çmimit të kontratës do të realizohet me pagesa javore, që do të kryhen në favor të Shoqërisë Kontraktuese nga Bashkia (Autoriteti Kontraktor).

7.2. Pagesa javore për mbetjet e dorëzuara nga Autoriteti Kontraktor bazohet në **sasinë e mbetjeve të depozituar gjatë javës dhe në çmimin për njësi/ton mbetje**.

7.3. Çmimi për njësi/ton mbetje përfshin garancinë për mbylljen e të gjithë shërbimeve (pranimi, grumbullimi, përpunimi, incenerimi), në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10463 datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe gjithë kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

7.4. Çmimi për ton mbetje të përpunuara, do të reflektojë kostot e shoqërisë për përpunimin e tyre, sipas planit ekonomik dhe buxhetit të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë kontraktuese.

7.5. Çmimi për ton mbetje nuk mund të ndryshohet gjatë afatit të zbatimit të kontratës, përveçse kur kanë ndryshuar kostot e shërbimit, pas miratimit të shprehur nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë kontraktuese.

7.6. Brënda 6(gjashtë) muajve nga fillimi i zbatimit të kësaj kontrate, shoqëria kontraktuese ka detyrimin të hartojë një analizë të detajuar të kostove faktike, që përfshihen në çmim. Nëse nga kjo analizë çmimi për njësi do të rezultojë i ndryshëm nga ai i përcaktuar në këtë kontratë, palët do të bëjnë rakordimet për detyrimet e ndërsjellta.

7.7. Modaliteti i ndryshimit të çmimit për njësi/ton mbetje do të bëhet transparent. Bashkia ka të drejtë të kërkojë një analizë të detajuar të kostove që përfshihen në çmim si dhe të kundërshtojë dhe paraqesë rezervat e saj kur gjykon që çmimi i përcaktuar nuk përfaqëson drejt dhe saktë kostot reale të shërbimit.

7.8. Çmimi aktual në këtë kontratë, i përcaktuar si më sipër, është 2,500 (dymijë e pesëqind) lekë/ton mbetje pa TVSH.



Neni 8

Mënyra e bërjes së pagesës

8.1. Shoqëria kontraktuese i paraqet Autoritetit Kontraktor një **Raport/Situacion** mbi sasinë e mbetjeve të pranuar, grumbulluara dhe përpunuara gjatë javës paraardhëse, si dhe një **Faturë** për shërbimet, bazuar në nenin 7.

8.2. Bashkia, nëpërmjet strukturave të saj, bën verifikimet dhe rakordimet me informacionin periodik të marrë nga shoqëria mbi sasinë e mbetjeve të depozituara, vërtetimet e transportuesve të lëshuara nga shoqëria kontraktuese për çdo ngarkesë. Në rast mospërputhjes apo pasaktësish, Bashkia e kthen faturën dhe raportin/situacionin për korrigjim. Raporti/Situacioni i paraqitur paguhet, pasi është nënshkruar nga mbikqyrësi/punonjësi/struktura e caktuar për monitorimin e kësaj kontrate nga Bashkia.

8.3. Pagesa e faturës bëhet brenda 10 ditëve nga paraqitja e saj, apo nga riparaqitja në rast korrigjimi.

8.4. Të gjitha pagesat sipas kontratës do të kryhen me transfertë bankare në llogarinë bankare të Shoqërisë Kontraktuese.

Llogaria e Bankës: BKT

IBAN i Bankës: AL5120531775007626CLPBCLALLE

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë Kontraktuese

9.1. Shoqëria Kontraktuese do të pranojë në ambjentet e saj, mbetjet urbane nga Bashkia të sjella nga ajo apo të tretë të kontraktuar prej saj. Pavarësisht sa mësipër, shoqëria nuk do të pranojë mbetje të rrezikshme të përcaktuara si të tilla nga Katalogu Shqiptar i Mbetjeve apo akte ligjore e nënligjore.

9.2. Shoqëria Kontraktuese do të garantojë të gjitha kushtet e nevojshme teknike për grumbullimin e mbetjeve, trajtimin e tyre dhe përpunimin në impjant, sipas standarteve dhe kërkesave të përcaktuara në lejen mjedisore dhe licencat e shoqërisë kontraktuese.

9.3. Shoqëria Kontraktuese do të peshojë të gjitha mbetjet e dërguara në ambjentet e saj, dhe do të pajisë transportuesin, qoftë i Bashkisë apo i të tretëve të kontraktuar prej saj, me vërtetimin e dërgesës së mbetjeve dhe peshën e tyre.

9.4. Shoqëria Kontraktuese do të përdorë regjistrimin në kohë reale për të regjistruar mbetjet që pranohen në vend depozitim dhe sisteme të besueshëm të informacionit të menaxhimit që lejojnë verifikimin e sasive të mbetjeve nga ana e Bashkisë.

9.5. Shoqëria Kontraktuese do të informojë Bashkinë periodikisht, **çdo javë**, për sasinë e mbetjeve të depozituara prej saj apo të tretëve të kontraktuar prej saj.

9.6. Punimet në vend-depozitim, trajtimi i mbetjeve, operacionet pas përpunimit dhe monitorimi do të kryhen në përputhje me legjislacionin, me lejen mjedisore dhe licencat e shoqërisë kontraktuese.

9.7. Shoqëria Kontraktuese do të informojë Bashkinë dhe do të paraqesë të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj, sa herë t'i kërkohet nga kjo e fundit, në lidhje me koston e shërbimit dhe çmimin e aplikuar.

9.8. Shoqëria Kontraktuese do të përfitojë prej Bashkisë pagesën e çmimit të kontratës.



Neni 10
Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë

10.1. Bashkia do të dorëzojë mbetjet urbane në ambjentet e shoqërisë, të caktuara nga kjo e fundit, nëpërmjet strukturave të saj apo të tretëve të kontraktuar prej saj.

10.2. Bashkia do të pajisë me autorizim të posaçëm të gjitha mjetet e transportit, të vetat apo të tretëve të kontraktuar prej saj, që do të kryejnë transportin e mbetjeve në ambjentet e shoqërisë.

10.3. Bashkia ka të drejtë të ushtrojë kontroll apo të inspektojë procesin e përpunimit të mbetjeve nga shoqëria, periodikisht apo në çdo kohë sipas gjykimit të saj.

10.4. Bashkia do të bëjë pagesën e çmimit të kontratës sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.

Neni 11
Përgjegjësia për shkeljet

11.1. Të gjitha sanksionet e vendosura nga autoritetet kompetente për shkeljen e ligjeve dhe rregulloreve që lidhen me veprimtaritë e Shoqërisë Kontraktuese janë përgjegjësi e kësaj të fundit.

11.2. Në rast se Shoqëria Kontraktuese nuk do të kryejë shërbimin në kohë dhe cilësi, sipas kësaj kontrate dhe kuadrit ligjor në fuqi, Autoriteti Kontraktor do të procedojë me pretendimet për dëmin e shkaktuar, sipas ligjit në fuqi.

11.3. Në rast se Autoriteti Kontraktor nuk do të procedojë me kryerjen e pagesës në kohë, sipas kontratës, ky i fundit do të mbajë përgjegjësi për shkeljen e Kontratës. Shoqëria Kontraktuese në këtë rast do të procedojë me pretendimet për dëmin e shkaktuar, sipas ligjit në fuqi.

Neni 12
Mbikqyrja e Kontratës

12.1. Për zbatimin e rregullt të Kontratës, palët autorizojnë Mbikqyrësin e Kontratës, përgjegjës për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Kontratës.

12.2. Mbikqyrësi i Kontratës i emëruar do të jetë përgjegjës për komunikimin midis Palëve, në lidhje me të gjitha çështjet kontraktuale. Në rast zëvendësimi të Mbikqyrësit aktual, njëra palë do të njoftojë menjëherë palën tjetër rreth këtij zëvendësimi.

12.3. Mbikqyrësi i Kontratës, i emëruar nga Shoqëria Kontraktuese është:

Z. Leli Kaja

Email: Ecoelb@gmail.com

Nr. telefoni: +355 693933345

12.4. Mbikqyrësi i Kontratës i emëruar nga Autoriteti Kontraktues është:

-Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Shërbimit Urban.

Z. Tauland Sinanaj.

Email: taulant.sinani@elbasani.gov.al

Nr. telefoni: +355 692065227



Neni 13

Mekanizma kundër parregullsive

13.1. Asnjëra nga palët nuk do të lejojë parregullsi në kryerjen e punës së vet sipas kontratës, dhe menjëherë do të njoftojë palën tjetër në rast se dyshohen parregullsi që lidhen me kontratën.

13.2. Asnjëra palë nuk do të nxjerrë informacion, të përcaktuar si konfidencial (me përdorim të kufizuar).

Neni 14

Ndërprerja e shërbimit për shkak të forcave madhore

Në rastet e dukurive të paparashikuara të zjarreve, tërmetejeve, reshjeve të dendura të borës, përmbytjeve, rrëshqitjeve të dheut, aksidenteve industriale dhe ndotjes mjedisore, Shoqëria Kontraktuese zbaton detyrimet e tij duke përmbushur objektin e kontratës, sipas Planit të emergjencave, udhëzimeve përkatëse dhe kushteve të lejes operative.

Neni 14

Përfundimi i Kontratës

14.1. Vlefshmëria e kësaj kontrate përfundon:

- i. me skadimin e afatit të Kontratës, sipas dispozitave të Kontratës;
- ii. në rast të ndryshimeve në ligje që e bëjnë të pamundur zbatimin e kësaj kontrate;

14.2. Në rastin e përfundimit të kontratës Autoriteti Kontraktor do t'i paguajë Shoqërisë Kontraktuese pagesën për punën e kryer përpara përfundimit të Kontratës.

Neni 15

Kushte të tjera

15.1. Të gjitha komunikimet midis palëve, të cilat lidhen me këtë kontratë, për të qenë të vlefshme duhet të bëhen me shkrim.

15.2. Çdo amendim i kësaj kontrate është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët.

Neni 16

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

16.1. Palët e kësaj Kontrate do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës ose që lidhen me kontratën, me interpretimin e saj, pavlefshmërinë, shkeljet ose përfundimin e saj, me negociim dhe marrëveshje të ndërsjelltë me shkrim. Në rast se mosmarrëveshja nuk arrin të zgjidhet me negociim e marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.

16.2. Për çështjet që nuk rregullohen sipas kësaj Kontrate, janë të vlefshme dispozitat e Kodit Civil Shqiptar.

Kontrata hartohet në tre kopje të njëjta, një për secilën palë.



Shoqëria Kontraktuese

“ECO-ELB” sh.a

Administratori

Leli KAJA

Autoriteti Kontraktor

BASHKIA ELBASAN

Kryetari i Bashkisë

Gledian LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 5 datë 31.01.2023
"Për

Miratimin e normave dhe kritere për disiplinimin e shpenzimeve për mjetet motorike në administrim të "Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan" për vitin 2023

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, të ligjit nr.115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan, në mbledhjen e tij të datës ____/____/____

VENDOSI:

1. Të miratojë normativat e konsumit të karburantit për mjetet motorike në administrim të Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan për vitin 2023 sipas tabelës bashkangjitur.
 2. Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë të gjitha masat për kontrollin dhe evidencimin e të gjitha lëvizjeve dhe orëve të punës të automjeteve, me qëllim mirëmenaxhimin e konsumit të karburantit, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
 3. Agjencia e Shërbimeve Publike Elbasan ka të drejtën dhe përgjegjësinë për përballimin me fonde të buxhetit vendor të njësive shpenzuese, të të gjitha shpenzimeve për karburant, pjesë këmbimi dhe të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera ligjore (kolaudimin, siguracionin, etj) për përdorimin normal të mjeteve motorike, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.
 4. Ngarkohet Drejtori i Agjensisë së Shërbimeve Publike Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Cuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Hektor Ciftja

Konceptoi: Specialist

A.BALLIU

Drejtori ASHP E.PALLOSHI

Zv/Kryetari A.Bylykbashi

**LISTA MAKINERIVE SIPAS INSTITUCIONEVE TE BASHKISE
(ADMINISTRATA)**

N r	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	KARBURANTI
1	AA 576 DF	Volkswagen	9 Litra/100 km Ne muaj 400Litra	Gazoil D 1
2	AA 101 DC	Volkswagen	9 Litra/100 km Ne muaj 250 litra	Gazoil D 1
3	AA 151 MD	Volkswagen	9Litra/100 km Ne muaj 300 litra	Gazoil D 1
4	AA 256 EG	Benz Mercedes	12 Litra/100 km Ne muaj 250 litra	Gazoil D 1
5	AA745 GB	Mercedez Benz	10litra/100 km ne muaj 300 litra	Gazoil D 1
6	AA 600 MJ	Volkswagen	8litra /100km	Gazoil D 1
7	AB 524 FY	Land Rover	13 litra/100 kmnr muaj 400 lit	Gazoil D 1

N r	Targa e mjetit	Tipi imjetit	Norma e konsumit	Karburanti
8	EL 0999 C	Benz Mercedes	12 Litra/100 km ne muaj 200 litra	Gazoil D1
9	TR 6377 H	Mitsubishi	20 Litra/100 km ne muaj 200 litra	Benzine

(POLICIA BASHKIAKE)

Nr	Targa e mjetit	Tipi imjetit	Norma e konsumit	Karburanti
10	EL 8732 A	Mitsubishi Pajero	13.5 Litra/100 km ne muaj 300litra	Gazoil D 1
11	EL 7475 B	Benz Mercedes	10 Litra/100 km ne muaj 200 litra	Gazoil D 1
12	EL 3318 C	Karrotrez	22 Litra/100 km ne muaj 150 litra	Gazoil D 1
13	AB 536 DF	Mitsubishi	12l/100 km ne muaj 300 Litra	Gazoil D 1
14	AB 560 DF	KIA	6.4 Litra /100 km 200 lit ne muaj	Benzine

(SHERBIMI PYJOR)

Nr	Targa e mjetit	Tipi i mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
15	AA 060 DJ	Toyota RAV 4	12 Litra/100 km ne muaj 100 litra	Gazoil D 1
16	EL 0738 C	Land Rover	14.4 Litra/100 km ne muaj 150 litra	Gazoil D 1
	AB 357 HN	Volksagen Amarok	12 LitA/100 KM Ne muaj 200 Litra	Gazoil D 1

19	AA 651 AO	Benz Mercedes	12 litra /100 km	Gazoil D 1
		FURGONAT		
20	AA 126 OB	Ford-Tranzit	10Litra/100 km	Gazoil D 1
		ESKAVATOR		
21		EskavatoreBenati	12 litra/ore	Gazoil
22		Eskavator Volvo	7 lit/ore	Gazoil
23		Eskavator Acerman	15 lit/ore	Gazoil
24	ATMB 86	Eskavator me goma FIAT HITACHI	17L/1 ore pune	Gazoil
25		Rul deri 12.90T	12L/1ore pune	Gazoil
26		Rul deri 12.9T	20L/me vibrim	Gazoil
27		Rul I vogel pioner	3 L/1 ore pune	Gazoil
28		Minieskavator ET-16	3.5 litra/oreduhet 3.5litra	GAZOIL D1
29		Eskavator ET-18	3.5LITRA/ore	
		TRAKTOR		
30		Traktor DT-75	9 litra/ore	GAZOIL D1
31		Traktor FT 125	22 litra/ore pune	GAZOIL D1
		KAMIONAT		
32	EL 5513 B	MakineKamion Benz	35 litra / 100 km	Gazoil D 1
33	EL 5509 B	Makine Kamion Benz	35 litra / 100 km	Gazoil D 1
34	EL 1427 C	Makine Kamion Benz	35 litra / 100 km	Gazoil D 1
35	AB 131 BE	Kamion man	40litra /100 km	Gazoil D 1
36	AB 156 BE	Kamion benz	45 litra /100 km	Gazoil D 1
		MAKINAT E PASTRIMIT		
37	AA 013 VL	Makine Pastrimi Iveco	4 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
38	AA 014 VL	Makine Pastrimi Iveco	4 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
39	TR 8683L	Volvo makine pastrimi	4litra/ore	Gazoil D 1
40	EL 676 A	Tricikel dopio gome	10 litra / 100 km	Gazoil D 1
42	AB 236 HS	Makine pastrimi Iveco	3.5 Litra/1 ore pune	Gazoil D 1

AGJENSIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

	Targa e mjetit	Tipi imjetit	Norma e konsumit	Karburanti
		AUTOVINCAT		
1	EL 9043 B	Autovinc Benz	10 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
2	EL 5132 B	Autovinc Volkswagen	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
3	AA 624 PM	Nissan autovinc	10 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
		FADROMAT		
4	EL 1565 C	FadromeFermec	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
5	EL 1338 C	FadromeKomatcu	9 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
6	EL 9881 B	Fadrome JSB	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
7	AB 132 BE	Fadrom fiat hitaci	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
8	AA 946 IV	Fadrome CATEPILAR	8 litra / 1 ore pune	Gazoil D 1
		KAMIONCINAT		
9	EL 0885 A	KamioncineIveco 3.2 Ton	16 litra / 100 km	Gazoil D 1
10	EL 1483 A	KamioncineIveco 3.5	15 litra / 100 km	Gazoil D 1
11	EL 1519 B	Kamioncine Benz 3.7 Ton	17 litra / 100 km	Gazoil D 1
12	AB 773 CK	Kamioncin ford tranzit	12 litra /100 km	Gazoil D 1
13	AB 864 CK	Kamioncin ford tranzit	12 litra /100 km	Gazoil D 1
14	EL 676 A	Tricikel dopio gome	10 litra /100 km	Gazoil D 1
		FORISTRADAT		
15	AA 150 HY	Mitsubishi Fuoristrade	13 litra / 100 km	Gazoil D 1
16	TR 3690 S	Mitsubishi L 200	12 litra / 100 km	Gazoil D 1
17	EL 1606 C	Mitsubishi L 200	13 litra / 100 km	Gazoil D 1
18	AA 664 NB	Toyota ILUX	12litra/100 km	Gazoil D 1
		AUTOVETURAT		

43	AB 320 HS	Makine pastrimi FORD	5 Litra/1 ore pune	Gazoil D 1
----	-----------	----------------------	--------------------	------------

Nr	TARGA	Mjete motorike	Norma e konsumit	Karburanti
44		Gjenerator 10 kw	0.7 l/ore	Gazoil D 1
45		Betoniere	1 Lit /1 m3	Benzine
46		Motorseke	0.6 l/ore	Benzine
47		Korse Bari	0.5 l/100 m2	Benzine
48		Motorrsharre Bordurash	0.6 l/ ore pune	Benzine
49		Freze	3.5L/1ore pune	Benzine
50		Motorrkorse me rrota	0.6l/100m2	Benzine
51		Motorrsaldatrice IANCIU	1.5l/ 1ore pune	Benzine

NORMATIVAT DHE KUOTAT MUJORE TE HARXHIMIT TE KARBURANTITPER VITIN 2023 PER MJETET ZJARREFIKESE:

Nr	TARGA	TIPI I MJETIT	LLOJI I LENDES DJEGESE	NORMATIVA PER CDO MJET
1	AA 152 UZ	Benz 1222	Diesel D1	Per 100 km 30lit per 1 ore ndezje ne vend 10 lit gazoil
2	AA 153 UZ	Benz 1117	Diesel D1	Per 100 km 17 litra per 1 ore ndezje ne vend 7 litra gazoil

3	AA 154 UZ	Benz Autoshkoll	Diesel D1	Per 100 km 27 litra per 1 ore punedhe 1 ore ndeze ne vend 9 litragazoil
4	AA 155 UZ	Reno S 150 Midliner	Diesel D1	Per 100 km 20 litra per 1 ore punedhenje ore ndeze ne vend 7 litragazoil
5	AA 156 UZ	Reanult Unimong	Diesel D1	Per 100 km 33 litra per 1 ore punedhe 1 ore ndeze ne vend 10 lit gazoil
6	AB 856 EK	Furgon Ford	Diesel D1	12 L/100KM
7	Nukka	Iveko 175 24	Diesel D1	Per 100 km 33 litra per 21 ore punedhe 1 ore ndeze ne vend 12 lit gazoil
8	Polic 1307	Kamioncin Volkswagen	Diesel D1	Per 100 km 12 litragazoil
9		Gjenerator I paisjeve te shpetimit	Benzin	Per 1 ore pune dhe 1 ore ndeze ne vend dhe harxhon 1.5 L/Ben
10		Motorsharre Stihl	Benzin	Per 1 ore pune harxhon 1.5L/benzin
11		Troko per prerje betoni dhe metale	Benzin	Per 1 ore pune harxhon 1.5L/benzin
12		Ventilator per pastrimin e tymit	Benzin	Per 1 ore pune harxhon 1.5L/benzin
13		Pompe thithese uji lambordini	Diesel D1	Per 1 ore pune harxhon 5 L/benzin
14		Pompe thithese iji mitsubishi	Benzine	

NORMATIVAT DHE KUOTAT MUJORE TE HARXHIMIT TE KARBURANTIT PER VITIN 2021 PER MJETET MOTORIKE TE QENDRES BALASHE:

Nr	TARGA	TIPI I MJETIT	LLOJI I KARBURANTIT	KONSUMI DITOR
1	EL 4389 C	Volsvagen	Gazoil D1	15litra /100 km
2	AA 382 FY	OPEL VIVARO	Gazoil D1	13 lit /100 km
3	AA 107 SY	Volsksvagen Cady	Gzazoil D1	15 litra /100 km

NORMATIVAT DHE KUOTAT MUJORE TE HARXHIMIT TE KARBURANTIT PER VITIN 2021 PER MJETET DHE PAISJE QE PERDOREN NGA DREJTORIA E QENDRES EKONOMIKE TE ARSIMIT:

Nr	TARGA	TIPI I MJETIT	LLOJI I KARBURANTIT	KONSUMI DITOR
1	EL 3319 C	Benz	Gazoil D1	13 litra /100 km
2	EL 7138 B	Ford Tranxit	Gazoil D1	14 litra /100 km
3	AA 035 AG	Volkswagen	Gazoil D1	9 litra /100 km

LISTA E MAKINAVE PER ADMINISTRATORET:

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
1	AA 579 EC	Volkswagen	8 lit/100 km Ne muaj 50 Litra	Benzine
2	AA 140 HM	Autoveture	7Litra/100 km Ne muaj 50 litra	Benzine
3	AA 730 MY	Skoda	8 Litra/100 km ne muaj 50 Litra	Gazoil D 1

4	AB 082 ER	Mercedez Benz	8 Litra/50 km Ne muaj 250 litra	Gazoil D 1
5	AA 904 EC	Polo	7litra/100 km ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
6	AB 620 MJ	Autoveture	8 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
7	AB 445 DF	BMV	8 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
8	AB 448 AB	Auto Volksw	9 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
9	AB 869 EE	Auto Opel	7 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
10	AA 171 OE	Auto Ford	6Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
11	AA 259 SA	Auto Ford	7 Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1
12	AA 628 KD	Auto Ford	5Litra/100 Km ,ne muaj 50 litra	Gazoil D 1

Konceptoi:Alemsha Balliu

Pergj/Sekt.Mekanik :G.Gaxhaj

Miratoi

Drejtori I Pergjithshem

Edvin Pallosi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

VENDIM

Nr. 4 Datë 31.01.2023

Për miratim në parim të dhënies së pëlqimit për shfrytëzimin e pronave shtetërore në Njësinë Administrative Tregan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 22 pika 1, neni 64/a; ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të ndryshuar; ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për mjedisin" të ndryshuar; ligjit nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet"; ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullësor" të ndryshuar; të VKM nr 550 datë 15.07.2020, si edhe pasi shqyrtoi kërkesat e subjekteve private sëbashku me relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e e Informacionit, Statistikave dhe Kordinimit:

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e pronave shtetërore në të cilat shtrihet rrjeti inxhinierik i Ujrave Termale në funksion të subjekteve që ushtrojnë aktivitet për qendrat e tyre kurative termale me vendndodhje në Njësinë Administrative Tregan.
2. Lista e subjekteve që do të lidhin marrëveshje me Bashkinë Elbasan do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Subjekti kërkuar	Nipt i subjektit	Procedura e rinovimit	Leje e përdorimit të Ujrave termale	Lloji i ujit	Zona Kadastrale	Nr.e pasurisë shtetërore
1	Apostol Debrova	L52602204A		Leje shfrytëzimi	Uji termal	3633	145/7, 141/8, 140/1/3, 138/1/2
2	Adrian Preçi	M12806204A		Leje shfrytëzimi	Uji termal	3633, 1407	8, 125, 281/1, 259/14, 259/2



3	Dritan Kumurija	L03320204J		Leje shfrytëzimi	Uji termal	3633	138/3/1 , 278 , 141/8 , 123/13 , 123/12 , 123/40
4	Entela Preci	M23421202E		Leje shfrytëzimi	Uji termal	3633 , 1407	8 , 125 , 281/1 , 259/14
5	Fatos Toromani	M13322203 N		Leje shfrytëzimi	Uji termal	3633	138/3/1 , 278 , 279/1 , 138/3/1
6	Gjergji Lici	K83123202J		Leje shfrytëzimi	Uji termal	3633	123/14 , 123/13 , 141/8 , 278
7	Oltjon Meta	L03320202Q	Rinovim i lejes ekzistuese		Uji termal	3633	236/38/1 , 8 , 260/1 , 281/1 , 282 , 125
8	Hysen Miza	L03405203V		Leje shfrytëzimi	Uji termal	3633	141/8 , 123/25 , 132/56 , 132/52 , 132/36

3. Subjektet përfitues të lejeve nga AMBU-ja do të lidhin kontratë e do të tarifohen sipas VKB-së nr.158 datë 30.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan për vitin 2023”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave dhe Aseteve, Drejtoria e Taksave, Tarifave Vendore, Drejtoria e Projektimit dhe Azhurnimit Topografik, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Informacionit, Statistikave dhe Kordinimit .

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Miratuar me 40 vota

Vota Pro 40

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 31/01 2023

KRYETARI

Hektor Çiftja





Nr. 679 prot.

158
31-1. 2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Elbasan, më 31.1. 2023

VENDIM

Nr 3 dt 31-01. 2023

“Për miratimin e anetaresimit ne grupin vendor te veprimit ne zonen rurale te Bashkise Elbasan dhe miratimin ne parim te Marrevershjes se Partneritetit si bashkethemelues”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 dt.17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar neni 54/d, te ligjit Nr.36/2022 dt 14.04.2022 ‘Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit me propozim të kryetarit të bashkisë
Këshilli bashkiak

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

- 1- Bashkia Elbasan të anëtarësohet në grupin vendor të veprimit në zonën rurale të bashkisë si bashkethemelues i saj.
- 2- Të miratojë marreveshje partneriteti te grupit Vendore të Veprimit të bashkisë Elbasan si bashkëthemelues i saj si organizatë jo fitim prurëse.
- 3- Përfaqësimi i bashkisë në këtë institucion do të jetë Zv/kryetari Artur Guni.
- 4- Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkise.
- 5- Ky vendim hyne në fuqi 10 dite pas shpalljes pas shpalljes publike (sipas percaktimeve te nenit 55,pika 6,te Ligjit nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”

Sekretari i Këshillit Bashkiak


Elvi Çuni

Miraturar me 40 vota

Vota Pro 40

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 31/01 2023

K R Y E T A R I


Hektor Çiftja



MARRËVESHJE PARTNERITETI TERRITORIAL

Për krijimin e Grupit Vendor të Veprimit (GVV)

_____ (emri)
lidhur në _____ (data, vendi)

Kjo Marrëveshje Partneriteti është e lidhur mes anëtarëve të mëposhtëm:

1. Emër Mbiemër, përfaqësues i _____ (emri i institucionit)
2. Emër Mbiemër, përfaqësues i _____ (emri i institucionit)
3. Emër Mbiemër, përfaqësues i _____ (emri i institucionit)
4. Emër Mbiemër, përfaqësues i _____ (emri i institucionit)
5. Emër Mbiemër, përfaqësues i _____ (emri i institucionit)

Të shtohen të gjithë pjesëmarrësit, pa limituar numrin e tyre.

Nënshkruesit e kësaj Marrëveshje, të cilët përfaqësojnë autoritetet publike, operatorët ekonomik dhe social, siç janë përmendur më sipër, ndajnë misionet të ngjashme dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë në fusha me interes të përbashkët për të rritur efektivitetin e përpjekjeve zhvillimore dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve të komunitetit vendor nëpërmjet zbatimit të qasjes LEADER sipas modelit të BE-së në nivel lokal.

Marrëveshja synon të krijojë kornizën institucionale për bashkëpunim territorial ndërmjet Palëve (autoritete publike, operatorë ekonomik dhe social) në fushat me interes të përbashkët, në veçanti zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve rurale.

Nënshkruesit deklarojnë se Partneriteti Lokal/territorial është themeluar mbi bazën e kritereve të formalizimit të partneritetit sipas qasjes LEADER;

Nënshkruesit kanë rënë dakord që zona LEADER¹, e përcaktuar nga Palët e marrëveshjes, shtrihet në kufinj të autoriteteve lokale mes Njësisve Administrative si më poshtë: (renditni

¹ Zona "LEADER" është një zonë rurale që përcakton kufijtë brenda të cilëve hartohet dhe zbatohet një strategji e veçantë e zhvillimit lokal e udhëhequr nga komuniteti.



emrat e bashkive/NJA-ve me zonat përkatëse të përfshira në territorin e tyre administrativ
territorin rural që do të përfshihet në zonën Leader);

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Partneriteti ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë civile, biznesit, sektorit publik vendor është të zyrtarizojë krijimin e GVV-së (Grupit Vendor të Veprimit)
_____ (emri)

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Partneriteti është lidhur për një periudhë kohore të pacaktuar.

Objektivi

Objektivi kryesor i GVV-së _____ (emri) është të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në komunitetet që janë pjesë e GVV-së _____ (emri) duke përdorur metodat dhe mjetet e disponueshme në kuadër të programeve aktuale dhe të ardhshme të mbështetjes së zhvillimit vendor të ofruara nga Qeveria e Shqipërisë, nga BE-ja dhe nga partnerë të tjerë zhvillimor.

Misioni

Misioni i GVV-së _____ (emri) është të përdorë të gjitha mjetet ligjore të mundshme për të arritur standarde të larta jetese për qytetarët që jetojnë në territorin e GVV-së (zona Leader), duke promovuar sipërmarrjen, përmirësuar vizibilitetin e komuniteteve brenda zonës Leader, duke vlerësuar traditat lokale, zakonet dhe atraktivitetin gjeografik, përmirësimin e përfshirjes sociale (për t'u plotësuar më tej sipas specifikave të vet GVV dhe zonës Leader që mbulon).

Funksionimi

GVV-ja _____ (emri) do të promovojë misionin e saj për zhvillimin e qëndrueshëm vendor dhe me pjesëmarrje, përmes përgatitjes dhe miratimit të strategjisë së zhvillimit



4

lokal të udhëhequr nga komuniteti për zonën "LEADER", dhe do të ndërmarrë veprime për zbatimin e strategjisë duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë anëtarët e komunitetit për të qënë pjesëmarrës dhe për të përfituar prej saj.

Struktura e GVV-së

GVV-ja krijohet dhe funksionon si organizatë jofitimprurëse me anëtarësi (shoqatë) sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.²

Struktura organizative e kërkuar ligjërisht³ për regjistrimin e një shoqate si GVV-s duhet të respektojë parimin e barazisë gjinore dhe të ketë në përbërje të paktën këto organe të brendshme⁴:

- a) Asamblenë e Përgjithshme;
- b) Bordin ekzekutiv;
- c) Personelin, që do të përfshijë të paktën:
 - a drejtorin ekzekutiv, i cili zgjidhet midis anëtarëve të bordit ekzekutiv nga vetë bordi, me propozim të presidenit;
 - b ekspertin kontabël.

Asambleja e Përgjithshme e GVV-së është organi më i lartë vendimmarrës në të cilin të gjithë anëtarët e GVV-së thirren në mbledhje të paktën 1 herë në vit. Asambleja është përgjegjëse për zgjedhjen e bordit dhe të presidentit nga radhët e anëtarëve të GVV-së. Këto zgjedhje duhet të ndjekin parimin e partneritetit, të barazisë territoriale, barazisë gjinore dhe të moshës.

Asambleja e Përgjithshme e GVV-së miraton një rregullore të brendshme, që përcakton procedurat e funksionimit të GVV-së, me qëllim garantimin e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e vendimmarrjes dhe në menaxhimin teknik dhe administrativ të aktiviteteve

Bordi i GVV-së është organi më i lartë ekzekutiv, ku përfaqësohen të gjithë partnerët e zonës "LEADER", të propozuar nga secila tipologji partnerësh, sipas parimit të partneritetit, i përcaktuar në (neni 5) Ligjin për ngritjen dhe funksionimin e GVV.

² Ligji nr. 80/2021 "Për organizatat jofitimprurëse"

³ Sipas Ligji Nr. 36/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve Vendore të veprimit"

⁴ Ligji Nr. 36/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve Vendore të veprimit"



Bordi i GVV-së është përgjegjës për vendimmarrjen e përditshme të GVV-së dhe për funksionimin ligjor dhe financiar të tij, për autorizimin e kostove operative, të cilat në çdo rast nuk mund të kalojnë 25% të shpenzimeve të fondeve publike të kryera në kuadër të strategjisë së zhvillimit lokal të udhëhequr nga komuniteti.

Anëtarësia e Bordit të GVV-së duhet të sigurojë: a) diversifikim të moshës e të barazisë gjinore dhe duhet të përfshijë: i. të paktën 2 gra; ii. të paktën 2 persona nën moshën 35 vjeç; b) të gjithë anëtarët e bordit duhet të jenë rezidentë në territorin e GVV-së.

Presidenti i GVV-së drejton mbledhjet e bordit. Të gjithë anëtarët e bordit duhet të firmosin një deklaratë konfidencialiteti për informacionet me të cilat njihen në pozicionet e tyre gjatë procesit të vendimmarrjes.

Bordi mund të ngrejë nënkomitete për të përgatitur dhe vlerësuar materialet që do të paraqiten për vendimmarrjen e bordit, të tilla si: nënkomitete bashkëpunimi, vlerësimi dhe monitorim projektesh.

Personeli i GVV-së mund të përfshijë këshilltarë/koordinatorë projektesh, këshilltarë/koordinatorë komuniteti, këshilltarë/koordinatorë biznesi, asistentë zyre etj., nëse konsiderohet e nevojshme.

Termat dhe kushtet e kësaj shprehje të vullnetit, që përcaktohet në këtë Marrëveshje, njihen dhe pranohen nga të gjithë Palët.

Vendi dhe data e firmosjes

Këtu firmosin të gjithë nënshkruesit e marrëveshjes

Emër Mbiemër

Emër Mbiemër

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Emër Mbiemër

Emër Mbiemër

Nënshkrimi

Nënshkrimi



Emër Mbiemër

Nënshkrimi

Emër Mbiemër

Nënshkrimi

Emër Mbiemër

Nënshkrimi

Emër Mbiemër

Nënshkrimi





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN
KARTELA SHOQËRUESE PRAKTIKE

Dërgues

Nr. Prot.

Datë

Shkurtimi i lëndës

Për trajtim nga:	A. Guni
(Struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	

Afati ☐ Normal (7 ditë) ☒ Prioritet (3 ditë) ☐ Urgjent (brenda ditës) ☐ Pa afat/Për dijeni/Tjetër

Data 10 / 2 / 23

Nr. Prot. 620 / 2

Nënshkrimi

Marrë në dorëzim

Nënshkrimi

Kalim për trajtim (struktura)

Me porosinë

Marrë në dorëzim

Nënshkrimi

Kalim për trajtim Specialisti

Me porosinë

Trajtim i materialit përfunduar më

Specialisti

Trajtim i materialit pranuar më

Përgjegjës Sektori

Trajtim i materialit miratuar më

Sekretari i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 158/1 Prot.

Elbasan më 9.2.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.3 datë 31.01.2023 "Për miratimin e anëtarësimit në grupin vendor të veprimit në zonën rurale të Bashkisë Elbasan dhe miratimin në parim të Marrëveshjes së Partneritetit si bashkëthemelues", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Majlinda Perriu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE ORGANIZATIVE
DREJTORIA INFORMACIONIT, STATISTIKAVE DHE KOORDINIMIT

Nr. 620 prot.

Elbasan, më 27.01.2023

RELACION

“Për miratimin e anetaresimit ne grupin vendor te veprimit ne zonen rurale te Bashkise Elbasan dhe miratimin ne parim te Marrevershjes se Partneritetit si bashkethemelues”

KESHILLIT BASHKIAK

Këtu

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Duke filluar nga muaji shtator 2022, bashkia Elbasan është partner i programit Barazi Gjinore Rurale dhe Turizëm (GREAT), financuar nga Qeveria Italiane dhe zbatuar nga UN Women dhe FAO në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë. Ndërhyrja ‘Mbështetje për fuqizimin ekonomik dhe social të grave rurale në bashkinë e Elbasanit’ në kuadër të GREAT që po zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural synon fuqizimin social-ekonomik të grave dhe vajzave në zonat rurale të bashkisë duke zbatuar instrumentin e politikës evropiane për zhvillimin e integruar rural – qasjen Leader.


Një nga komponentët kryesor të ndërhyrjes është krijimi i Grupit Vendor të Veprimit (GVV) në zonat rurale të bashkisë Elbasan në përputhje me Ligjin Nr.36/2022, datë 14.04.2022 “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore te veprimit”. Kjo filozofi dhe instrument zhvillimi synon të inkurajojë krijimin e partneriteteve në nivel nënrajonar ndërmjet tre sektorëve, atij publik, privat dhe civil. Që nga prezantimi i metodës LEADER në vitin 1991 në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, tashmë njihet në mbarë botën si praktikë e mirë që fuqizon komunitet vendore për të hartuar dhe zbatuar në mënyrë aktive strategjinë e zhvillimit të tyre. Si një histori suksesi evropiane, qasja Leader ka potencialin të shndërrohet në një instrument tepër të rëndësishëm për fuqizimin e komuniteteve lokale në bashkinë e Elbasanit dhe në komunitete të tjera të vendit, duke i orientuar ato drejt një zhvillimi të integruar.

Juristja D.I.S.K:
P/Sektori D.I.S.K:
Pranoi:
Drejtori D.I.S.K:

D. Çomo
I. Kaculi
Sh. Bullari

ZV/KRYETARI
Aulona Bylykbashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 521/1 Prot

Elbasan më 31/01/2023

VENDIM
Nr. 2 datë 31/01/2023

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin DHJETOR 2022

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 31.01.2022 "Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **DHJETOR 2022** gjithsej 280 familje me një fond prej 1.224.012 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social B.Musaj
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elvi Cuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Hektor Çiftja